

**LIGJ**  
**Nr.7671, datë 9.2.1993**

**"PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7521, DATË 30.10.1991 "PËR PËRKRAHJEN SOCIALE PËR PERSONAT QË DALIN TË PAPUNË NGA ZBATIMI I REFORMËS EKONOMIKE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7579, DATË 2.7.1992**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr.7521, datë 30.10.1991, ndryshuar me ligjin nr.7579, datë 2.7.1992, bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2 shtohet shkronja "f" me këtë përmbajtje:

"Ish-punonjësit e kooperativave bujqësore që kanë dalë të papunë nga prishja e tyre dhe që në kohën e prishjes kanë qenë me banim në qytet, qendra të banuara e ndërmarrje bujqësore, në qoftë se nuk kanë përfituar përkrahje sociale ose tokë".

**Neni 2**

Në nenin 6 shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:

"Ish-punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore, familjet e të cilëve përfitojnë tokë, duke filluar nga data 1.6.1993".

**Neni 3**

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

Në paragrafin e dytë ku thuhet "deri në datën 31.12.1992" të zëvendësohet me "deri në datën 30.4.1993".

Në paragrafin e fundit ku thuhet "Pas datës 31.12.1992", të zëvendësohet me "Pas datës 30.4.1993".

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.461, datë 16.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha**